

NJOFTIM PËR VEND PUNE

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, kreu IV – “Pranimi në shërbimin civil”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njofton se në administratën e tij **ka vend të lirë pune, në pozicionin “specialist finance”, në Shërbimin e Financës dhe Buxhetit.**

-Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

Kandidati duhet të ketë njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike; aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

-Konkursi do të kalojë në këto faza: dorëzimi i dokumentacionit brenda 30 ditëve kalendarike nga shpallja; verifikimi i kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta - pas 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit dhe shpallja e listës së kandidatëve që kualifikohen për në fazën e dytë; testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

-Konkurrimi do të bëhet për 1 (një) vend të lirë pune.

- **Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë:**

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

-Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

-Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

-Përshkrimi i përgjithshëm i punës: Të realizojë dhe të kontrollojë kryerjen e pagesave të pagave, shpërblimeve, shpenzimeve të deputeteve dhe sigurimeve shoqërore, bazuar në legjislacionin në fuqi.

- **Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**

-Të ketë diplomë universitare bachelor dhe master profesional/shkencor, në ekonomi ose ekonomi-financë.

-Të ketë përvojë në punë deri në një vit.

-Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (njësia përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant; një kopje të jetëshkrimit (CV); fotokopje e diplomës- nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin; fotokopje e listës së notave - nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin

e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar; një fotokopje e librezës së punës e plotësuar; vërtetim i gjendjes gjyqësore; certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme; fotokopje e letërnjohimit.

-Pranimi i dokumenteve do të bëhet deri në **datën 5.7.2014.**

-Në datën 14.7.2014 do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

-Konkurrimi-**testimi me shkrim** do të bëhet në **datën 7.8.2014**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10-00.**

-Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: vlerësimi i jetëshkrimit - **15 pikë**, intervista e strukturuar me gojë - **15 pikë** dhe testimi me shkrim - **70 pikë.**

-Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, kur kandidati merr 40 pikë e lart, ai i nënshtrohet intervistës së strukturuar me gojë.

-Lista e fituesve nga 70 pikë e lart do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut, në datën 8.8.2014.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni 2278 270 dhe 2278 425 ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë.